



Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në bazë të neneve 3.1, 3.4, 15.1 pikat (a) dhe (c) dhe 21.2, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58 dhe 59 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Viti III, Nr 28, dt.4 qershor 2008),

Me qëllim të rregullimit të operimit të mjeteve ajrore në Republikën e Kosovës në përputhje me Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara të përcaktuara në Aneksin 6 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE NR. 7/2014 MBI OPERIMIN E MJETEVE AJRORE

Neni 1

Fusha e zbatimit

1.1 Kjo Rregullore përcakton kërkesat për sigurimin e funksionimit të mjeteve fluturuese në përputhje me Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara (SPR) përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC), të përcaktuara në Aneksin 6 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

1.2 Operimet e mjeteve ajrore në Republikën e Kosovës do të rregullohen në bazë të dispozitave të SPR të Aneksit 6, Pjesa I - Transporti ajror ndërkombëtar komercial - Aeroplanët, Shtojcat 1-9, Shtesat A-K siç është publikuar në Botimin e 9 korrikut të vitit 2010 nga ONAC; Pjesa II - Aviacioni i përgjithshëm ndërkombëtar - Aeroplanët, Shtojcat 2.1, 2.2, 2.3, Shtesat 2.A, 3.A, 3.B të publikuara në Botimin e 7 korrikut të vitit 2008 nga ONAC, dhe Pjesa III - Operimet ndërkombëtare - Helikopterët, Shtojcat 1-5, Shtesat A-I të publikuara në Botimin e 7 korrikut të vitit 2010 nga ONAC.

Neni 2

Zbatimi i SPR-ve

2.1 Aneksi 6 për Operimin e mjeteve ajrore, siç është përcaktuar sipas nenit 1 paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje, do të zbatohet në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2.2 SPR-të e zbatueshme, të specifikuara në Aneksin 6 Pjesa I, II, III si dhe Shtojcat dhe Shtesat e saj, do të jenë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përveç nëse dispozitat e nenit 4 të kësaj Rregulloreje tregojnë ndryshe.

Neni 3 Shprehjet dhe përkufizimet

3.1 Për qëllim të kësaj Rregulloreje, termet “Shtet Kontraktues”, “Shtet”, “Autoritet i përshtatshëm”, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përdorura në njëjës apo në shumës në Aneksin 6 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, siç përcaktohet më sipër në nenin 1, paragrafi 2, do të lexohen si “Republika e Kosovës”.

3.2 Dallimet e listuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, për qëllim të kësaj Rregulloreje nënkuptojnë qoftë shmangien nga standardi ose ngritjen e një praktike të rekomanduar në nivelin e standardit.

Neni 4 Dallimet nga SPR-të

4.1 Dallimet e zbatueshme nga SPR-të e Aneksit 6 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar të specifikuara në nenin 1, paragrafi 2 të kësaj Rregulloreje, janë listuar sipas renditjes vijuese:

PJESA I - TRANSPORTI AJROR NDËRKOMBËTAR KOMERCIAL - AEROPLANËT:

a) Kapitulli 4, Operimet e fluturimit, Neni 4.2.4 Udhëzimet operative - Në përgjithësi, Rekomandimi 4.2.4.3 do të jetë i zbatueshëm si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

b) Kapitulli 4, Operimet e fluturimit, Neni 4.2.7 Lartësitë minimale të fluturimit, Rekomandimi 4.2.7.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

c) Kapitulli 4, Operimet e fluturimit, Neni 4.2.7 Lartësitë minimale të fluturimit, Rekomandimi 4.2.7.4 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

d) Kapitulli 4, Operimet e fluturimit, Neni 4.4.9 Procedurat operative të aeroplanëve për zvogëlimin e zhurmës, Rekomandimi 4.4.9.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

e) Kapitulli 4, Operimet e fluturimit, Neni 4.4.9 Procedurat operative të aeroplanëve për zvogëlimin e zhurmës, Rekomandimi 4.4.9.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

f) Kapitulli 4, Operimet e fluturimit, Neni 4.10 Menaxhimi i lodhjes, Rekomandimi 4.10.7 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

g) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e Fluturimit, Neni 6.2 Të gjithë aeroplanët në të gjitha fluturimet, Rekomandimi - "Furnizimet mjekësore duhet të përbëjnë:" nën 6.2.2 a) 1 dhe 3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

h) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e Fluturimit, Neni 6.2 Të gjithë aeroplanët në të gjitha fluturimet, Rekomandimi - "rripat e sigurisë për çdo karrige të pilotit:" nën 6.2.2 c) 3) **Shënimi**, do të jetë i zbatueshëm si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

i) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.3.1 Regjistruesit e të dhënave të fluturimit dhe sistemet e mjetit ajror për regjistrimin e të dhënave, Rekomandimi 6.3.1.2.5 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012 - CAT.IDE.A.190 (a) (3)): "*Aeroplanët me shtytje të turbinës shumë-motorëshe me një MCTOM prej 5 700 kg ose më pak, me një MOPSC prej më shumë se nëntë dhe që i është lëshuar një CofA individuale më ose pas 1 prillit të vitit 1998*";

j) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.3.1 Regjistruesit e të dhënave të fluturimit dhe sistemet e mjetit ajror për regjistrimin e të dhënave, Rekomandimi 6.3.1.2.7 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

k) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.3.1 Regjistruesit e të dhënave të fluturimit dhe sistemet e mjetit ajror për regjistrimin e të dhënave, Rekomandimi 6.3.1.2.10 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

l) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.3.2 Regjistruesit e zërit në kabinë dhe sistemet për regjistrimin e zërit, Rekomandimi 6.3.2.1.2 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012): "*Aeroplanët me shtytje të turbinës shumë-motorëshe me një MCTOM prej 5 700 kg ose më pak, me një MOPSC prej më shumë se nëntë dhe që i është lëshuar një CofA individuale më ose pas 1 janarit të vitit 1990*";

m) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e Fluturimit, Neni 6.3.2 Regjistruesit e zërit në kabinë dhe sistemet për regjistrimin e zërit, Rekomandimi 6.3.2.1.6 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012): "*Mjetet ajrore me një MCTOM prej më shumë se 5 700 kg*";

n) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e Fluturimit, Neni 6.3.2 Regjistruesit e zërit në kabinë dhe sistemet për regjistrimin e zërit, Rekomandimi 6.3.2.3.3 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012): "*CVR do të jetë i aftë për të mbajtur të dhënat e regjistruara gjatë së paku 2 orëve paraprake në rastin e mjeteve ajrore me një MCTOM prej më shumë se 5 700 kg kur CofA individuale i është lëshuar më ose pas 1 prillit të vitit 1998*";

o) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.3.4 regjistruesit e fluturimit - Në përgjithësi, Rekomandimi 6.3.4.5.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

p) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.3.4 regjistruesit e fluturimit - Në përgjithësi, Rekomandimi 6.3.4.5.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

q) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.3.4 regjistruesit e fluturimit - Në përgjithësi, Rekomandimi 6.3.4.5.4 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

r) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.7 Të gjithë aeroplanët në fluturim me lartësi të madhe, Rekomandimi 6.7.4 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

s) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.7 Të gjithë aeroplanët në fluturim me lartësi të madhe, Rekomandimi 6.7.6 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

t) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e Fluturimit, Neni 6.11 aeroplanët me ajër që mbahet nën presion kur bartin pasagjerë - radarë të motit, Rekomandimi do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012): "*Aeroplanët vijues do të jenë të pajisur me pajisje ajrore për zbulimin e motit kur operohen gjatë natës ose në IMC në zonat ku mund të pritet që të ekzistojnë përgjatë rrugës stuhi apo kushte tjera atmosferike potencialisht të rrezikshme, të cilat konsiderohen si të dallueshme me pajisje ajrore për zbulimin e motit:*

(a) mjetet ajrore me ajër të mbajtur nën presion, (b) mjetet ajrore pa ajër të mbajtur nën presion me MCTOM prej më shumë se 5 700 kg; dhe (c) mjetet ajrore pa ajër të mbajtur nën presion me MOPSC prej më shumë se nëntë";

u) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.16 Aeroplanët që transportojnë pasagjerë - vende të ekuipazhit të kabinës, Rekomandimi 6.16.2 do të jetë i zbatueshëm si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

v) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.17 Transmetuesit për lokalizim në rast të emergjencës (ELT), Rekomandimi 6.17.1 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012): "*Aeroplanët me një MOPSC prej 19 ose më pak do të jenë të pajisur me të paktën: (1) një ELT automatike, në rastin e mjeteve ajrore të cilëve i është lëshuar një CofA individuale për herë të parë pas 1 korrikut të vitit 2008; ose (2) një ELT të çfarëdo lloji, në rastin e mjeteve ajrore të cilëve i është lëshuar një CofA individuale më ose para 1 korrikut të vitit 2008*";

w) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.18 Aeroplanët që duhet të jenë të pajisur me një sistem ajror për shmangien e përplasjes (ACAS II), Rekomandimi 6.18.3 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- CAT.IDE.A.155): "*Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me Rregulloren (BE) Nr [...] / 2011, aeroplanët me shtytje të turbinës me një MCTOM prej më shumë se 5 700 kg ose MOPSC prej më shumë se 19 do të jenë të pajisur me ACAS II*";

x) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.19 Kushtet për transponder të raportimit të presionit-lartësisë, Rekomandimi 6.19.4 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- CAT.IDE.A.350): "*Aeroplanët duhet të jenë të pajisur me një transponder të Radarit për vëzhgim sekondar (SSR) për raportim të presionit-lartësisë dhe çfarëdo aftësie tjetër e transponderit SSR që nevojitet për rrugën që është duke u fluturuar*";

y) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.21 Mjetet ajrore me motor turboreaktiv - sistemet progresive për paralajmërim të erërave të cilat për një kohë shkurtër ndryshojnë në shpejtësi dhe drejtim (windshear), Rekomandimi 6.21.1 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-CAT.IDE.A.150): "*Aeroplanët me shtytje të turbinës që kanë një MCTOM prej më shumë se 5 700 kg ose një MOPSC prej më shumë se nëntë do të jenë të pajisur me një TAWS që plotëson kërkesat për pajisjet e Klasit A siç është përcaktuar në një Standard të pranueshëm*";

z) Kapitulli 6, Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 6.21 Mjetet ajrore me motor turboreaktiv - sistemet progresive për paralajmërim të "windshear", Rekomandimi 6.21.2 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-CAT.IDE.A.150): "*Aeroplanët me shtytje të turbinës që kanë një MCTOM prej më shumë se 5 700 kg ose një MOPSC prej më shumë se*

nëntë do të jenë të pajisur me një TAWS që plotëson kërkesat për pajisjet e Klasit A siç është përcaktuar në një Standard të pranueshëm";

aa) Kapitulli 9, Ekuipazhi i aeroplanit, Neni 9.4.5 Operimet me një pilot sipas rregullave instrumentale të fluturimit (IFR) ose gjatë natës, Rekomandimi 9.4.5.2 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- ORO.FC.202):

a. "Për operimet e aeroplanëve nën IFR piloti do të ketë: (1) një minimum prej 50 orë kohë të fluturimit nën IFR në llojin ose klasën përkatëse të aeroplanit, nga të cilat 10 orë janë në pozitën e komandantit, dhe (2) të ketë kryer në periudhën e mëparshme prej 90 ditësh në llojin ose klasën përkatëse të aeroplanit: (i) pesë fluturime IFR, duke përfshirë tri ardhje instrumentale, në rolin me një pilot; ose (ii) një kontrollim të ardhjes instrumentale IFR";

b. "Për operimet e aeroplanëve gjatë natës piloti do të ketë: (1) një minimum prej 15 orë kohë të fluturimit gjatë natës të cilat mund të përfshihen në 50 orë kohë të fluturimit nën IFR në (c)(1); dhe (2) të ketë kryer në periudhën e mëparshme prej 90 ditësh në llojin ose klasën përkatëse të aeroplanit: (i) tri ngritje dhe atertime gjatë natës në rolin me një pilot; ose (ii) një ngritje gjatë natës dhe kontrollim të aterimit";

bb) Kapitulli 10, Zyrtari për Operime të Fluturimit / Dispeçeri i Fluturimit, Rekomandimi 10.4 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-AMC3 ORO.MLR.100 - D Trajnimi): *"Sillabuset e Trajnimit dhe programet e kontrollit për të gjithë personelin e operimeve të caktuara në detyra operative në lidhje me përgatitjen dhe/ose kryerjen e një fluturimi. Sillabusi i Trajnimit dhe programet e kontrollit duhet të përfshijnë si në vijim: 2.5 për personelin e operimeve përveç anëtarëve të ekuipazhit (p.sh. dispeçerët, personeli i trajtimit etj), të gjitha gjërat tjera përkatëse të përcaktuara në Aneksin IV (Pjesa-CAT) dhe në këtë Aneks që kanë të bëjnë me detyrat e tyre";*

cc) Kapitulli 11, Manualët, regjistrat dhe të dhënat, Neni 11.3 Program i mirëmbajtjes, Rekomandimi 11.3.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

dd) Kapitulli 11, Manualët, regjistrat dhe të dhënat, Neni 11.4 Regjistri i udhëtimit, Rekomandimi 11.4.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

ee) Kapitulli 11, Manualët, regjistrat dhe të dhënat, Neni 11.4 Regjistri i udhëtimit, Rekomandimi 11.4.2 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-AMC1 ORO.MLR.110 (b)): *"Informacioni, ose pjesët e tyre mund të regjistrohen në ndonjë formë tjetër përpos formës së shtypur në letër. Qasshmëria, përdorshmëria dhe besueshmëria duhet të sigurohen";*

ff) Kapitulli 11, Manualët, regjistrat dhe të dhënat, Neni 11.4 Regjistri i udhëtimit, Rekomandimi 11.4.3 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-ORO.MLR.115): "Informatat në vijim të përdorura për përgatitjen dhe kryerjen e një fluturimi, dhe raportet e ndërlydhura, do të ruhen për 3 muaj: (5) në regjister të udhëtimit, ose në një mënyrë ekuivalente;"

gg) Kapitulli 13, Sigurimi, Neni 13.1 Operimet komerciale vendore, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

hh) Kapitulli 13, Sigurimi, Neni 13.2 Siguria e pjesës së ndarë për vendosje të ekuipazhit të fluturimit, Rekomandimi 13.2.4 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-ORO.SEC.100.A (b)): "të gjithë aeroplanët për bartje të pasagjerëve me një masë maksimale të ngritjes të certifikuar që tejkalon 45 500 kg, apo me një MOPSC prej më shumë se 60, të angazhuar në transportin komercial të udhëtarëve, do të jenë të pajisur me një derë të pjesës së ndarë për vendosje të ekuipazhit të fluturimit të aprovuar që është në gjendje të mbyllet dhe të hapet nga cilado pozitë e pilotit dhe e dizajnuar për të përmbushur kërkesat e zbatueshme të përshtatshmërisë për fluturim;"

ii) Kapitulli 13, Sigurimi, Neni 13.2 Sigurimi i pjesës së ndarë për vendosje të ekuipazhit të fluturimit, Rekomandimi 13.2.5 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-ORO.SEC.100.A (c)): "Në të gjithë aeroplanët të cilët janë të pajisur me një derë të pjesës së ndarë për vendosje të ekuipazhit të fluturimit në përputhje me pikën (b) më sipër: (1) kjo derë do të jetë e mbyllur para ndezjes së motorëve për ngritje dhe do të mbetet e mbyllur kur kërkohet sipas procedurave të sigurimit ose nga piloti komandues gjer me rastin e ndalimit të motorëve pas aterimit, përveç kur vlerësohet e nevojshme për hyrjen ose daljen e personave të autorizuar në përputhje me programet kombëtare të sigurimit të aviacionit civil, dhe (2) duhet të ofrohen mjetet për monitorim nga cilado pozitë e pilotit e të gjithë zonës së derës jashtë pjesës së ndarë për vendosje të ekuipazhit të fluturimit për të identifikuar personat që kërkojnë hyrjen dhe për të zbuluar sjelljet e dyshimta apo kërcënimet potenciale;"

jj) Shtojca 2, Organizimi dhe Përmbajtja e Manualit të Operimeve, Neni 1. Organizimi, Rekomandimi 1.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

kk) Shtojca 5, Mbikëqyrja e Sigurisë së Operatorëve ajror, 5. Personelit teknik i kualifikuar, Rekomandimi 5.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

ll) Shtojca 5, Mbikëqyrja e Sigurisë së Operatorëve ajror, 5. Personeli i kualifikuar teknik, Rekomandimi 5.5 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-ARO.GEN.200 (a) (2)): "(2) një numër i mjaftueshëm i personelit për të kryer detyrat e veta dhe për të ushtruar përgjegjësitë e veta. Personeli i tillë do të jetë i kualifikuar për të kryer detyrat e veta të përcaktuara dhe të ketë njohuritë, përvojën, trajnimin fillestar dhe periodik të nevojshëm për të siguruar kompetencën e

vazhdueshme. Një sistem duhet të vendoset për të planifikuar disponueshmërinë e personelit, për të siguruar zbatimin e duhur të të gjitha detyrave;”

PJESA II - AVIACIONI I PËRGJITHSHËM NDËRKOMBËTAR - AEROPLANËT

Neni I - Në përgjithësi

Nuk ka

Neni II - Operimet e Aviacionit të Përgjithshëm

- a) Kapitulli 2.1 Në përgjithësi, Neni 2.1.1 Përputhshmëria me ligjet, rregulloret dhe procedurat, Rekomandimi 2.1.1.5 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- b) Kapitulli 2.2 Operimet e fluturimit, Neni 2.2.3 Përgatitja e fluturimit, Rekomandimi 2.2.3.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- c) Kapitulli 2.2 Operimet e fluturimit, Neni 2.2.3.7 Rimbushja me karburant gjatë kohës kur pasagjerët gjenden në bord, Rekomandimi 2.2.3.7.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- d) Kapitulli 2.2 Operimet e fluturimit, Neni 2.2.4.2 Raportimi i motit nga pilotët, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- e) Kapitulli 2.2 Operimet e fluturimit, Neni 2.2.4.3 Kushte të rrezikshme të fluturimit, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- f) Kapitulli 2.2 Operimet e fluturimit, Neni 2.2.4.3 Kushte të rrezikshme të fluturimit, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- g) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 2.4.2 Aeroplanët në të gjitha fluturimet, Rekomandimi 2.4.2.4 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- h) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 2.4.2 Aeroplanët në të gjitha fluturimet, Rekomandimi 2.4.2.5 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- i) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 2.4.3 Aeroplanët e operuar si fluturime VFR, Rekomandimi 2.4.3.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

j) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 2.4.4 Aeroplanët për fluturime mbi ujë, Rekomandimi 2.4.4.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

k) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 2.4.6 Aeroplanët në fluturimet me lartësi të madhe, Rekomandimi 2.4.6.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

l) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 2.4.11 Aeroplanët të cilët duhet të jenë të pajisur me sisteme paralajmëruese për afërsi të tokës (GPWS), Rekomandimi 2.4.11.6 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

m) Kapitulli 2.4 Instrumentet, Pajisje dhe Dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 2.4.12 Transmetuesit për lokalizim në rast të emergjencës (ELT), Rekomandimi 2.4.12.1 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 800/2013: QKK.IDE.A.215; NCC.IDE.H.215; NCO.IDE.A.170 dhe NCO.IDE.H.170);

n) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 2.4.14 Mikrofonat, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

o) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 2.4.16.2 Regjistruerit e zërit në kabinë dhe sistemet për regjistrimin e zërit, Rekomandimi 2.4.16.2.1.1 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 800/2013: NCC.IDE.A.160);

p) Kapitulli 2.4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 2.4.16.2 Regjistruerit e zërit në kabinë dhe sistemet për regjistrimin e zërit, Rekomandimi 2.4.16.2.3.3 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 800/2013: NCC.IDE.A.160);

q) Kapitulli 2.8 Manualet, regjistrat dhe të dhënat, Neni 2.8.2 Regjistri i udhëtimit, Rekomandimi 2.8.2.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

Neni III - Aeroplanët e mëdhenj dhe turboreaktiv

a) Kapitulli 3.3 Në përgjithësi, Neni 3.3.2 Sistemi i menaxhimit të sigurisë, Rekomandimi 3.3.2.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

b) Kapitulli 3.4 Operimet e fluturimit, Neni 3.4.2.3 Udhëzimet operative - Në përgjithësi, Rekomandimi 3.4.2.3.2 do të jetë i zbatueshëm si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

- c) Kapitulli 3.4 Operimet e fluturimit, Neni 3.4.3 Përgatitja e Fluturimit, Rekomandimi 3.4.3.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- d) Kapitulli 3.4 Operimet e fluturimit, Neni 3.4.4 Procedurat gjatë fluturimit, Rekomandimi 3.4.4.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- e) Kapitulli 3.4 Operimet e fluturimit, Neni 3.4.4 Procedurat gjatë fluturimit, Rekomandimi 3.4.4.3.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- f) Kapitulli 3.4 Operimet e fluturimit, Neni 3.4.4 Procedurat gjatë fluturimit, Rekomandimi 3.4.4.3.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- g) Kapitulli 3.6 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 3.6.1 Në përgjithësi, Rekomandimi 3.6.1.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- h) Kapitulli 3.6 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 3.6.2 Aeroplanët në të gjitha fluturimet, Rekomandimi 3.6.2.1 (b) do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- i) Kapitulli 3.6 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 3.6.9 Aeroplanët që transportojnë pasagjerë - vendet për anëtarët e ekuipazhit të kabinës, Rekomandimi 3.6.9.2.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- j) Kapitulli 3.6 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të aeroplanit, Neni 3.6.10 Aeroplanët që duhet të jenë të pajisur me një sistem ajror për shmangien e përplasjes (ACAS), Rekomandimi 3.6.10.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- k) Kapitulli 3.6 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit, Neni 3.6.10 Aeroplanët që duhet të jenë të pajisur me një sistem ajror për shmangien e përplasjes (ACAS), Rekomandimi 3.6.10.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- l) Kapitulli 3.8 Mirëmbajtja e Aeroplanit, Neni 3.8.1 Përgjegjësitë e operatorit të mirëmbajtjes, Rekomandimi 3.8.1.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- m) Kapitulli 3.8 Mirëmbajtja e Aeroplanit, Neni 3.8.2 Manuali i Operatorit për kontrollin e mirëmbajtjes, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;
- n) Kapitulli 3.10 Zyrtari për Operim të Fluturimit / Dispeçeri i Fluturimit, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

o) Kapitulli 3.11 Manualet, regjistrat dhe të dhënat, Neni 3.11.1 Manuali i Operatorit për kontrollin e mirëmbajtjes, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

p) Kapitulli 3.11 Manualet, regjistrat dhe të dhënat, Neni 3.11.2 Programi i Mirëmbajtjes, Rekomandimi 3.11.2.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

q) Kapitulli 3.12 Ekuipazhi i kabinës, Neni 3.12.4 Trajnimi, Rekomandimi 3.12.4.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

r) Kapitulli 3.12 Sigurimi, Neni 3.13.1 Programi i Sigurimit, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

PJESA III - OPERIMET NDËRKOMBËTARE - HELIKOPTERËT

Neni I - Në përgjithësi

Nuk ka

Neni II - Transporti ajror ndërkombëtar komercial

a) Kapitulli 2 Operimet e fluturimit, Neni 2.2.4 Udhëzimet operative - Në përgjithësi, Rekomandimi 2.2.4.3 do të jetë i zbatueshëm si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

b) Kapitulli 2 Operimet e fluturimit, Neni 2.2.7 Lartësia minimale e fluturimit (operimet nën IFR), Rekomandimi 2.2.7.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

c) Kapitulli 2 Operimet e fluturimit, Neni 2.2.7 Lartësia minimale e fluturimit (operimet nën IFR), Rekomandimi 2.2.7.4 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

d) Kapitulli 2 Operimet e fluturimit, Neni 2.3.4 Fushat alternative të helikopterëve, Rekomandimi 2.3.4.4 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-GM1 CAT.OP.MPA.181): "*Kur operohet në det të hapur, çdo kapacitet rezervë i ngarkesës duhet të përdoret për të bartur karburant shtesë nëse kjo do të lehtësojë përdorimin e një aerodromi alternativ në tokë;*"

e) Kapitulli 2 Operimet e fluturimit, Neni 2.4.6 Ruajtja e ekuipazhit të aeroplanit dhe pasagjerëve në aeroplan me ajër nën presion në rast të humbjes së presionit të ajrit, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

f) Kapitulli 2 Operimet e fluturimit, Neni 2.4.8 Procedurat operative të helikopterëve për zvogëlimin e zhurmës, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

g) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.2 Të gjithë helikopterët për të gjitha fluturimet, Rekomandimi "Furnizimet mjekësore duhet të përfshijnë:" nën 4.2.2 a) (1) do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

h) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.3.1 Regjistruerit e të dhënave të fluturimit dhe sistemet e mjetit ajror për regjistrimin e të dhënave, Rekomandimi 4.3.1.2.3 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-CAT.IDE.H.190 (a)): "*helikopterët e mëposhtëm do të jenë të pajisur me një FDR që përdor një metodë digjitale të regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave dhe për të cilat është në dispozicion një metodë e gatshme që të dhënat të nxirren nga një medium për ruajtje: (1) helikopterët me një MCTOM prej më shumë se 3 175 kg dhe për të cilët është lëshuar për herë të parë një CofA individuale më ose pas datës 1 gusht të vitit 1999, (2) helikopterët me një MCTOM prej më shumë se 7 000 kg, ose një MOPSC prej më shumë se nëntë, dhe për të cilët është lëshuar një CofA individuale më ose pas 1 Janarit të vitit 1989, por para 1 gushtit të vitit 1999;*"

i) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterit, Neni 4.3.2 Regjistruerit i zërit në kabinë, Rekomandimi 4.3.2.1.2 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-CAT.IDE.H.185 (a)): "*Ky lloj helikopteri do të jetë i pajisur me një Regjistruer të zërit në kabinë (CVR): (1) të gjithë helikopterët me një MCTOM prej më shumë se 7 000 kg, dhe (2) helikopterët me një MCTOM prej më shumë se 3 175 kg dhe që për herë të parë i është lëshuara një CofA individuale më ose pas datës 1 janar të vitit 1987;*"

j) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterit, Neni 4.3.2 Regjistruerit i zërit në kabinë, Rekomandimi 4.3.2.3.3 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-CAT.IDE.H.185 (b)): "*(1) 2 orët paraprake për helikopterët e përmendur në (a)(1) dhe (a) (2), kur për herë të parë i'u është lëshuar një CofA individuale më ose pas 1 Janarit të vitit 2016; (2) 1 orë paraprake për helikopterë të përmendur në (a)(1), kur për herë të parë i është lëshuar një CofA individuale më ose para 1 gushtit të vitit 1999 dhe para 1 janarit të vitit 2016, (3) 30 minuta paraprakë për helikopterët e përmendur në (a)(1), kur për herë të parë i është lëshuar një CofA individual përpara 1 gushtit të vitit 1999; ose (4) 30 minuta paraprakë për helikopterë të përmendur në (a) (2), kur për herë të parë i është lëshuar një CofA individuale para 1 janarit të vitit 2016;*"

k) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.5.2 Pajisjet emergjente, Rekomandimi 4.4.2.1 (b) do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

l) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.5.2 Pajisjet emergjente, Rekomandimi 4.5.2.1 (b) do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

m) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterit, Neni 4.5.2 Pajisjet emergjente, Rekomandimi 4.5.2.6 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-AMC1 CAT.IDE.H.300 (a) (3)): "*(3) kur gjendet më tepër se një trap shpëtimi në bord, të paktën 50 % prej tyre duhet të mund të dislokohen nga ana e ekuipazhit përderisa janë të ulur në vendet e tyre të zakonshme, kur është e nevojshme me telekomandë;*"

n) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterit, Neni 4.5.2 Pajisjet emergjente, Rekomandimi 4.5.2.7 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-AMC1 CAT.IDE.H.300 (a) (4)): "*(4) trapet për shpëtim të jetës që nuk janë të dislokueshëm me telekomandë ose nga ana e ekuipazhit duhet të jenë me një peshë të tillë që lejon trajtimin nga një person. 40 kg duhet të konsiderohet si një peshë maksimale;*"

o) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterit, Neni 4.5.2 Pajisjet emergjente, Rekomandimi 4.5.2.8 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-AMC1 CAT.IDE.H.300 (a)): "*(a) Çdo trap për shpëtim të jetës duhet të jetë në përputhje me specifikimet e mëposhtme: (1) të jetë i një dizajni të miratuar dhe i vendosur në mënyrë që të lehtësojë përdorimin e lehtë në raste emergjente, (2) të jetë i dukshëm nga pajisjet standarde ajrore të radarit; (3) kur gjendet më shumë se një trap për shpëtim të jetës në bord, së paku 50 % prej tyre duhet të jenë në gjendje të dislokohen nga ekuipazhi në pozicion të ulur në pozicionet e veta normale, në raste kur është e nevojshme përmes telekomandës; dhe (4) trapet për shpëtim të jetës që nuk janë të dislokueshëm me telekomandë ose nga ana e ekuipazhit duhet të jenë me një peshë të tillë që lejon trajtimin nga një person. 40 kg duhet të konsiderohet si një peshë maksimale;*"

p) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.5.3 Të gjithë helikopterët në fluturime mbi zona të përcaktuara detare, Rekomandimi 4.5.3.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

q) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.10 Helikopterët që transportojnë pasagjerë - zbulimi i motit domethënës, Rekomandimi do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012-AMC1 CAT.IDE.H.160): "*Helikopterët me një MOPSC prej më shumë se nëntë dhe që operohen nën IFR ose natën, do të jenë të pajisur me pajisje ajrore për zbulimin e motit, kur raportet aktuale të motit tregojnë mbi stuhi apo kushte tjera potencialisht të rrezikshme të motit që mund të pritet të ekzistojnë përgjatë rrugës së fluturimit, që konsiderohen si të zbulueshme me pajisje ajrore për zbulimin e motit;*"

r) Kapitulli 8 Zyrtari për Operime të Fluturimit / Dispeçeri i Fluturimit, Rekomandimi 8.4 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- AMC3 ORO.MLR.100 - D Trajnimi): *"Sillabuset e Trajnimit dhe programet e kontrollit për të gjitha operimet e personelit të caktuar në detyra operative në lidhje me përgatitjen dhe / ose ekzekutimin e një fluturimi. Sillabuset e trajnimit dhe programet e kontrollit duhet të përfshijnë si në vijim: 2.5 për personelin e operimeve përveç anëtarëve të ekuipazhit (p.sh. dispeçerin, personelin e trajtimit, etj), të gjitha gjërat tjera relevante të përcaktuara në Aneksin IV (Pjesa-CAT) dhe në këtë Aneks lidhur me detyrat e tyre;"*

s) Kapitulli 9 Manualet, regjistrat dhe të dhënat, Neni 9.3 Programi i mirëmbajtjes, Rekomandimi 9.3.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

t) Kapitulli 9 Manualet, regjistrat dhe të dhënat, Neni 9.4 Regjistri i udhëtimit, Rekomandimi 9.4.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

u) Kapitulli 9 Manualet, regjistrat dhe të dhënat, Neni 9.4 Regjistri i udhëtimit, Rekomandimi 9.4.2 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- AMC1 ORO.MLR.110 (b)): *"Informacioni, ose pjesët e tyre, mund të regjistrohen në ndonjë formë tjetër përpos formës së shtypur në letër. Qasshmëria, përdorshmëria dhe besueshmëria duhet të sigurohen;"*

v) Kapitulli 9 Manualet, regjistrat dhe të dhënat, Neni 9.4 Regjistri i udhëtimit, Rekomandimi 9.4.3 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- ORO.MLR.115): *"informatat në vijim të përdorura për përgatitjen dhe kryerjen e një fluturimi, dhe raportet e ndërlydhura, do të ruhen për 3 muaj: (5) në regjistër të udhëtimit, ose në një mënyrë ekuivalente;"*

Neni III - Aviacioni i përgjithshëm ndërkombëtar

a) Kapitulli 1 Manualet, regjistrat dhe të dhënat, Neni 1.1 Pajtueshmëria me ligjet, rregulloret dhe procedurat, Rekomandimi 1.1.5 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

b) Kapitulli 2 Operacionet e fluturimit, Neni 2.7 Fushat alternative të helikopterëve, Rekomandimi 2.7.3 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012 GM1 CAT.OP.MPA.181): *"Kur operohet në det të hapur, çdo kapacitet rezervë i ngarkesës duhet të përdoret për të bartur karburant shtesë nëse kjo do të lehtësojë përdorimin e një aerodromi alternativ në tokë;"*

c) Kapitulli 2 Operacionet e fluturimit, Neni 2.13 Kushtet e rrezikshme të fluturimit, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

d) Kapitulli 2 Operacionet e fluturimit, Neni 2.15.4 Rripat e sigurisë, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

e) Kapitulli 2 Operacionet e fluturimit, Neni 2.18 Rimbushja e karburantit gjatë kohës kur pasagjerët janë në bord ose me helikë të kthyer, Rekomandimi 2.18.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

f) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.1.3 Pajisjet, Rekomandimi 4.1.3.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

g) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.1.3 Pajisjet, Rekomandimi 4.1.3.4 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

h) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterit, Neni 4.3.2 Pajisjet emergjente, Rekomandimi 4.3.2.4 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- AMC1 NCC.IDE.H.227 (a) (3)): "*(3) kur gjendet më shumë se një trap për shpëtim të jetës në bord, së paku 50 % duhet të jenë në gjendje të dislokohen nga ekuipazhi në pozicion të ulur në pozicionet e veta normale, në raste kur është e nevojshme përmes telekomandës;*"

i) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterit, Neni 4.3.2 Pajisjet emergjente, Rekomandimi 4.3.2.5 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- AMC1 NCC.IDE.H.227 (a) (4)): "*trapet për shpëtim të jetës që nuk janë të dislokueshëm me telekomandë ose nga ana e ekuipazhit duhet të jenë me një peshë të tillë që lejon trajtimin nga një person. 40 kg duhet të konsiderohet si një peshë maksimale;*"

j) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterit, Neni 4.3.2 Pajisjet emergjente, Rekomandimi 4.3.2.6 do të zbatohet si Standard me ndryshim ndaj tekstit sipas Operimeve Ajrore (Rregullorja e BE-së 965/2012- AMC1 NCC.IDE.H.227 (a)): "*(a) Çdo trap për shpëtim të jetës duhet të jetë në përputhje me specifikimet e mëposhtme: (1) të jetë i një dizajni të miratuar dhe i vendosur në mënyrë që të lehtësojë përdorimin në raste urgjente, (2) të jetë i dukshëm nga pajisjet standarde ajrore të radarit; (3) kur gjendet më shumë se një trap për shpëtim të jetës në bord, së paku 50 % të tyre duhet të jenë në gjendje të dislokohen nga ekuipazhi në pozicion të ulur në pozicionet e veta normale, në raste kur është e nevojshme përmes telekomandës; dhe (4) trapet për shpëtim të jetës që nuk janë të dislokueshëm me telekomandë ose nga ana e ekuipazhit duhet të jenë me një peshë të tillë që lejon trajtimin nga një person. 40 kg duhet të konsiderohet si një peshë maksimale;*"

k) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.9 Helikopterët që duhet të jenë të pajisur me një transponder për raportim të

presionit-lartësisë, Rekomandimin 4.9.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

l) Kapitulli 4 Instrumentet, pajisjet dhe dokumentet e fluturimit të helikopterëve, Neni 4.10 Mikrofonat, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

m) Kapitulli 5 Pajisjet e Komunikimit dhe Navigimit të helikopterit, Neni 5.1 Pajisjet e komunikimit, Rekomandimi 5.1.5 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

n) Shtojca 1 Mbikëqyrja e Sigurisë së Operatorëve ajror, Neni 5. Personeli teknik i kualifikuar, Rekomandimi 5.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

o) Shtojca 1 Mbikëqyrja e Sigurisë së Operatorëve ajror, Neni 5. Personeli teknik i kualifikuar, Rekomandimi 5.5 do të zbatohet si Standard pa ndryshim ndaj tekstit;

4.2 Dallimet e listuara në paragrafin 1 të këtij neni do të publikohen në Publikimin e Informacionit Aeronautike (AIP), njëzet e tetë (28) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Neni 5 Disponueshmëria

Teksti i SPR-ve të rishikuara të Aneksit 6, siç është përcaktuar në nenin 1, paragrafi 2, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, i është bashkangjitur kësaj Rregulloreje si Shtojca 1, 2 dhe 3.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 17 prill 2014.

Prishtinë, 2 prill 2014.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm